



Njoftim Publik

Në drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar aplikacioni 05nr.350/02-202864/23 dt.06.10.2023, në emër të Pronarve, Rexhep Zuka, Hida Elshani, Naser Arifi, Bajram Beka, Skender Azemi nga Prishtina dhe Investitori "GESHTENJA GROUP" sh.p.k. me seli në Pejë, rr.Beteja e Kosharës me certifikatë të biznesit ARBK 810748634, me pronar Qamil Hadergjonaj nga Peja, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimore/projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste – Ndërtesa "1" me 3B+P+13, në kuadër të Bilokut "B", Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Qendër" në Prishtinë-PZHU-së, konkretisht parcelave: nr.1013-25 1013-28, 1016-3, 1016-2, 1016-24, 1016-23, 1016-22, 1016-7, 1016-6, 1016-5, 1016-21, 1016-11 dhe 1016-14 ZK Matigan, sipas projekt propozimit / Planit të situacionit - "zgjidhjes urbane" të prezantuar.

Me aplikacion është prezantuar edhe projekt propozimi për ndërtimin e kompleksit të lartcekur. Bazuar në pikën 2 të nimit 18 të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, "Organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së lejes së ndërtimit". Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 10.11.2023 deri me datën 25.11.2023 në Email adresën: urbanizmpriштine@rks-gov.net.

Kushtet e propozuara: Ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesa "1" me 3B+P+13	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	"Kullosë e Klasës 4" / Tokë ndërtimore
b. Vija rregulluese	0.0m' Sipas Planit rregullues Prishtina e Re - Zona Qendër"
c. Vija ndërtimore	3.0m' Sipas Planit rregullues Prishtina e Re - Zona Qendër"
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	3.0m' / 25m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	Anësor: 7.0m'/34m' & 7.0m'/34m' Pasmë: 7.0m'/34m' & 7.0m'/34m'
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	Koeficienti 3.5 – S=14,527.48m ² , sip. ndërtimore mbi tokë
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	40% - S=1,383.57m ² e lejuar, S=1,383.45m ² e propozuar
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGI)	40% - S=1,383.57m ² i lejuar dhe S=1,328m ² , në tokë & 320m ² në kulm e propozuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	60% - S=2,075.35m ² , lejuar & S=2,000.52m ² - propozuar,
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	141 VP në ndërtesa
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqen e Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përfshihen numri i kërkesës të shënuar më lartë.
Nënshkrimi i Zyrtarit:

